Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**02.08.2023**	**14.08.2023**	**2023/0529**
Eksperti Teknik **Bademe Mullalija**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **03.08.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 31.07.2023, OE "DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0529, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sherbime per Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim per Ndertesat Qeveritare" me nr. të prokurimit: "214-23-6093-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 316,560.00 €.

Njoftimi për kontratë: 20.06.2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0529 i dt:31.07.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik

Neni 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik

Neni 9 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik

O Neni 27 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik

Neni 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik

Neni 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik

Neni 13 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Neni 47 par. 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Neni 48 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Neni 48 par.2 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Fillimisht paraqiten pretendimet e përgjithshme të procesit të tenderimit që konsiderojmë se nuk janë respektuar nga AK, as nuk janë marrë parasysh në rastin e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pra në një formë janë injoruar dhe nuk ka asnjë përgjigje apo elaborim lidhur me pretendime në mënyrë specifike por të përgjithësuar, të cilat do ti listojmë si në vijim:

Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1 par. 1, 2 dhe 3 të ligjit për Prokurim Publik. Ashtu që neni 3 par.1 i Ligjit për Prokurimin publik përcakton se "*Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla*", e që AK, në mënyrë direkte i shkelë të tre paragrafët e nenit 1 të LPP-së, me rastin e përgatitjes së një specifikacioni të tillë në dosjen e tenderit.

Autoriteti Kontraktues ka dështuar të veprojë sipas nenit 7 par.1 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*", *lidhur me par.5 të nenit 7 të LPP-së, ceket se "Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.* Autoriteti kontraktues e shkel nenin 7 te LPP-së, në të gjashtë paragrafët me rastin e përgatitjes se një specifikacioni të tillë në dosjen e tenderit për shkak se kërkon menaxher të kualifikuar, certifikuar për menaxhim të mjedisit me përvojë pune min. 3 vite, në kryerjen e shërbimeve të DDD. Kurse në të njëjtën kohë cek se operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojnë se kanë 1 Epidemiolog ose Agronom ose Veterinar ose Ekolog, gjë e cila paraqet standard të dyfishte profesional, dhe janë kërkesa që bijën ndesh apo në kundërshtim me njëra tjetër sepse operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik i bije që përpos që p.sh. Të njëjtin person 1 Epidemiolog ose Agronom ose Veterinar ose Ekolog, gjithsesi se duhet të jetë edhe menaxher, andaj kjo pikë e dosjes së tenderit sipas pyetjes se parë të bërë na ne si OE, paraqet standard favorizues për ndonjë OE, të caktuar e për ne në të njëjtën kohë edhe është kriter diskriminues.

Autoriteti kontraktues ka bere shkelje nenit 7 par.1 të LPP-së, përsëri në rastin kur kanë kërkuar diplomë universitare për menaxher dhe i çertifikuar për mbrojtjen e mjedisit me përvojë pune min. 3 vite në kryerjen e shërbimeve të DDD, që i përkasin vetëm mjedisit, bujqësi, biologji, kimi dhe ekologji. Kjo pikë si përgjigje e dhënë nga AK është në kundërshtim me përgjigjen e parë të dhënë për shkak se aty ka cekur se edhe epidemiologu kërkohet, kurse në përgjigjen e dytë jo, që këto tani janë në kundërshtim me njëra tjetrën, po ashtu pse duhet të jetë menaxher i mjedisit dhe pse duhet të jetë i çertifikaur, kjo është diskriminuese dhe standard të dyfishte profesional.

Autoriteti kontraktues ka bere shkelje të nenit 7 të LPP-së, përsëri në rastin kur kanë kërkuar që CV, të jetë e nënshkruar, kurse edhe në përgjigjen e dhënë vetëm kanë cekur se kërkesa mbetet e njëjtë si në dosjen e tenderit, por kjo kërkesë që CV, të nënshkruhet është një kërkesë absurde dhe shumë e panevojshme për arsye se CV, vetëm në mënyrë të shkurtër paraqet profilin e personit që i dedikohet dhe është fakt notor pra i ditur botërisht që CV-ja, asnjëherë nuk kërkohet e nënshkruar, prandaj kjo duhet hequr/përmirësuar si kërkesë në dosjen e tenderit.

toriteti kontraktues ka bere shkelje te këtij neni të lartë cekur përsëri në rastin kur kanë kërkuar vetëm një gjenerator Ultra Low Volume –ULV, për mbi 224,7000.00 m², duke cekur në përgjigjen e AK, se kinse vetëm një gjenerator i tillë është i mjaftueshëm për arsye se vetëm Pallati i Drejtësisë ka një sipërfaqe prej 13,960.00 metra katror kurse objektet tjera me sipërfaqe të ulta deri në 20 m², e që sipas tyre mund të kryhet me pompa tjera, mirëpo një konstatim i tillë i AK, nuk është i saktë sepse ky proces tenderimi është me të gjitha objektet qeveritare e që objekt qeveritar është edhe objekti i AKI-së, apo Ministrive tjera përkatëse, që si të tilla nuk i ka 20 m², pra kemi sipërfaqe shumë më të madhe e që nuk mund të kryhet me pompa tjera dhe pa gjenerator, andaj kjo kërkesë vetëm për një gjenerator është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, për shkak se

shihet qartë se me këtë po favorizohet ndonjë OE, që ka vetëm një gjenerator. Vlen te ceket se AUTORITETI KONTRAKTUES nuk kerkon asnje automjet per kryerjen e sherbimeve, ku per kete projekt madhor duhen te jene se paku 5 automjete per bartjen e gjeneratoreve, punetore, pompa motorike etj.

Autoriteti kontraktues ka dështuar të veproj konform nenit 6 të LPP-së, në të cilin ceket se "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.", ndërsa autoriteti kontraktues vepron kunder këtij neni e rrjedhimisht kundër ligjit te prokurimit publik në tërësi me rastin e vendosjes se kërkesës për 3 pompa ULV Elektrike dhe 3 pompa ULV Elektrostatike, pra duke i kërkuar gjithsejte 6 pompa që në mënyrë automatike dëmton buxhetin publik pra të shtetit, si dhe përgjigjja e AK, se kinse këto pompa nuk janë të njëjta pra kinse pompat ULV elektrike janë pompa që mund të përdoren për dezinsektim dhe dezinfektim, kurse pompa ULV Elektrostatike vetëm për dezinfektim, por që ky një konstatim i gabuar dhe jo i saktë nga ana e AK, për shkak se pompa ULV Elektrostatike përdoren edhe për dezinfektim edhe për dezinsektim madje janë edhe shumë profesionale.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur edhe nenin 9 par.1 të LPP-së, përcaktohet se "Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë; (iv) përfitimet e pritura nga secili objekt i tillë; (v) në rastin e pajisjeve, mallrave të qëndrueshme dhe punëve, përllogaritja e shpenzimeve të disponimit gjatë tërë afatit të përdorimit të objektit, duke përfshirë shpenzimet e blerjes, operative, mirëmbajtjes si dhe vlerës së mbetur; (vi) një njoftim, mbi atë se nëse aktiviteti i tillë i prokurimit ishte përfshirë në planifikimin e prokurimit, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe nëse nuk ishte përfshirë, atëherë një deklaratë mbi arsyet e mos-përfshirjes së tillë; dhe (vii) konstatimin e saktë mbi atë se në çfarë mënyre do të avancojë prokurimi përkatës synimet institucionale të autoritetit kontraktues" andaj vlerësojmë se AK ka bërë shkelje të këtij nenit me rastin e kërkesën për një pajisje adekuate për insekte me avull të nxeht dhe të thatë (sqarim: Avull i nxehet dhe i thatë nuk ekziston), për lirimin e avullit të nxeht nga temp. 60 C deri në 200 C, dhe nga AK është kërkuar minimun deri në 60 C, që kinse kjo temperaturë e mjaftueshme për eliminimin e insekteve, vezëve dhe lavrave të tyre, dhe kinse kjo kërkesë është që të mos eliminohet konkurrenca, por që AK, këtu bënë shkelje pikërisht të konkurrencës duke favorizuar ndonjë OE që ka këtë pajisje, po ashtu vlen të ceket se temperatura adekuate për ti eliminuar lavrat dhe vezët është 100 C, deri në 180 C, dhe në asnjë mënyrë 60 C.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, në rastin e kërkesës për repelent për largimin e brejtësve me përmbajtje organike dhe jo të rrezikshme për njerëz dhe mjedisin, por

ky një konstatim i gabuar nga ana e AK, për arsye se së pari për brejtës nuk duhet të përdoren Repelent por duhet të kryhet shërbimi i Deratizimit që shërben për eleminimin dhe kontrollimin e brejtësve, e jo repelent, sepse me repelent psh. Në hapësira të mëdha siç është pallati i drejtësisë i bije qe, brejtësit vetëm i largon nga një hapësirë/objekt e i dërgon në një tjetër, pra nuk duhet repelent por duhet të kryhet shërbimi i Deratizimit siç u sqarua më lartë.

utoriteti Kontraktues në pikën që ka të bëjë me atë se OE duhet ti mbledhin brejtësit e ngordhur dhe deponimi i tyre është përgjegjësi e tyre, po ashtu në dosjen e tenderit kanë cekur se brejtësit e ngordhur duhet të dërgohet në deponi të autorizuara për të njëjtat, e sipas AK, në Kosovës kinse paska deponi të autorizuara për këto gjëra që nuk është e vërtet, dhe në mënyrë automatike e lenë përgjegjësinë tek OE.

Autoriteti Kontraktues në specifikacionin teknik ka kërkuar për Parandalimin – Largimin e dëmtueseve tjerë (zvarranikëve dhe shpendëve), ka cekur se duhet përdor Cinamon oil, Canfora oil ose ekuvalente, por i ka futur në një kategori, që është gabim ,por që ky është një gabim sepse AK, në mënyrë të gabuar i ka dhënë produkte të njëjta sikurse për largimin e zvarranikëve ashtu edhe të shpendëve, por për largimin e shpendëve ka produkte tjera shumë më efikase si gjemba, shirita elektrik. Po ashtu AK ka injoruar pyetjet e bëra nga OE, pra nuk është përgjigjur.

Autoriteti Kontraktues në specifikacionin teknik ka kërkuar të përdoren pllaka aromatike me ngjitës të mijëve jo toksike për njerëz, kurse pyetja jonë si OE, ka qenë si dëshmohet se ngjitësat janë jo toksik, kurse AK, ka theksuar se për të dëshmuar cilësinë e perparateve të kërkuara duhet të ofrohen kopjet e çertifikatave të analizave dhe MSDS, por gabimisht është kjo përgjigje sepse fillimisht këtu janë kërkuar ngjitësa dhe jo preparate, këto ngjitësa si të tilla nuk kanë çertifikata të analizave dhe as MSDS, por vetëm përcillen me letër nga prodhuesi që nuk janë toksike, andaj AK në këtë mënyrë redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 9 të LPP-së, me rastin e mos-harmonizimit te kërkesave në terren dhe numrit të punëtorëve që duhet dhe janë të nevojshëm për përfundimin e këtij projekti sepse edhe sipas vetë AK, ky projekt është madhor, e në anën tjetër në dosjen e tenderit pretendon që në afatin prej 30 ditësh ta përfundoj me 8 punëtorë është shumë e pa qartë dhe vështirë e realizueshme, sepse ne si OE, kemi planifikuar për këtë tender ta realizojmë eventualisht me 15 punëtor për shkak të afatit të shkurtër të ekzekutimit të punëve.

Janë ripërsëritur edhe në ankesë pretendimet sikurse në kërkesën për rishqyrtim për arsye se AK, me qëllim apo pa qëllim ka dështuar të arsyetoj në mënyrë detale të gjitha pretendimet tona të ngritura, pra kemi vetëm parafrazime të dispozitave ligjore pa asnjë elaborim, pastaj vetëm sa kanë marrë copy paste të gjitha pretendime kurse asnjë nuk e kanë trajtuar në mënyrë të saktë dhe të plotë, vlen të ceket se në faqen 6 të vendimit në paragrafin e parë AK ka cekur se "AK për Stafin Profesional për realizimin të këtij projekti nuk ka kërkuar ti kenë në marrëdhënie punë por ka mundësuar që Operatori Ekonomik pjesëmarrës të ofrojnë Kontratë ose marrëveshjen e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt.....", ky arsyetim jepet tek pretendimet e ngritura lidhur

me kërkesën që operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojnë se kanë 1 Epidemiolog ose Agronom ose Veterinar ose Ekolog, kurse pretendimi jonë nuk ka pasur të bëjë farë me atë se a duhet të ketë kontratë pune apo marrëveshje pune, që sqarimi i AK, lidhur me këtë është në tërësi i gabuar sepse pavarësisht a ke kontratë punë në çfarë do afati ajo është marrëdhënie pune, por pretendimi jonë ka qenë se të njëjtin person 1 Epidemiolog ose Agronom ose Veterinar ose Ekolog, gjithsesi se duhet të jetë edhe menaxher, andaj kjo pikë e dosjes së tenderit sipas pyetjes se parë të bërë nga ne si OE, paraqet standard favorizues për ndonjë OE, e ky një dallim esencial, pra pretendimet tona janë paraqitur pa përgjigje në vendimin e AK, si dhe përgjigjet janë shtrembëruar. Vetëm mund të behët një krahasim i thjesht nga OSHP lidhur me pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe lehtë konstatohet se vendimi i AK, ka dështuar të arsyetoj pretendimet e ngritura dhe me këtë rast ka bërë shkelje të dispozitave të lartë cekura të LPP-së.

Me lartë u sqaruar shkeljet e përgjithshme lidhur me procedurën e tenderimit, kurse më poshtë do të paraqesim shkeljet e radhës të AK, në lidhje me ligjshmërinë e vendimit, përkatësisht kundërligjshmërinë e tij.

Vendimi i dt. 28.07.202 nga AK Ministria e Punëve të Brendshme – Divizioni i Prokurimit, për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, nuk është i mbështetur në asnjë dispozitë ligjore, në këtë vendim nuk ka pjesën arsyetuese të tij të shënuar se përse është marrë një vendim i tillë, i njëjti në fillim ka të cekur se është vendim, kurse në fund ka një konkluzion në formë të dispozitivit, po ashtu nuk e ka kështillën juridike për ushtrimin e mjeteve juridike që përpos që janë shkelje ligjore por edhe shkelje Kushtetuese.

Mbështetur në nenin 47 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative është përcaktuar Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, përkatësisht në paragrafin 1.1. të këtij neni dhe ligji përcaktohet se duhet të ketë "*pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2.* ***pjesën urdhëruese (dispozitivin)****, që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dipozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (kështillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë*".

Që të gjitha këto parakushte për një vendim të ligjshëm dhe të zbatueshëm e të kuptueshëm nga pala, po ashtu mundë vetën sepse janë dy dispozitiva por ashtu edhe arsyetimi marr në pjesën e dispozitivit të vendimit në pjesën jo te duhur të vendimit e bënë atë kontradiktor me veten po ashtu edhe arsyetimi i vendimit nuk është bërë në vlerësim të fakteve dhe provave apo dispozitave ligjore por vetëm ka marr shabllon pretendimet e ngritura në kërkesën për rishqyrtim dhe nuk janë elaboruar, andaj edhe arsyetimi si element i detyrueshëm i aktit administrativ është pjesa arsyetuese e tij, duke pasur parasysh këtë rëndësinë e arsyetimit të një akti administrativ e sanksionon edhe neni 48 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në të cilin përcaktohet se: "1. *Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:*

1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;

1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;

1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;

1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;

1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;

1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën

e dhënë në vendim."

Lidhur me paragrafin 2 të po të njëjti nen dhe ligj përcaktohet se: "Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.", në këtë dispozitë ligjore shumë qartë theksohet se akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar për shpjegimin e situatës faktike, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare si dhe bazën ligjore, kurse vendimi i AK datë 28.07.2023 nuk plotëson asnjë prej këtyre kushteve ligjore, për shkak se nuk kemi as edhe një fjali të vetme lidhur me arsyetimin e pretendimeve të palës ankuese, as një vlerësim të asnjë provë apo faktit vendimtar dhe nuk kemi as edhe një citim të duhur te dispozitave ligjore, e që në mënyrë automatike ky vendim është edhe i kundërligjshëm edhe duhet anuluar në tërësi.

Mbështetur në nenin 52 paragrafi 1.4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet se akti administrativ është i paligjshëm nëse: "*është nxjerr në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ*", gjë që vendimi i dt.28.07.2023, konform këtyre dispozitave është në tërësi i paligjshëm.

Po ashtu vendimi i dt. 28.07.2023, i mungon edhe pjesa e Këshillës Juridike si element kryesor, për udhëzimin e palës për ushtrimin e mjeteve juridike, që është kategori kushtetuese e sanksionuar me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se "*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj*". Këtë të drejtë e rregullon edhe neni 13 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton se "*Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik*", po ashtu edhe neni 109 par. 1 të LPP-së, përcaktohet se "*Ankesa mund të dorëzohet nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktiviteteve ose procedurave të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje të këtij ligji*". Kështu që AK, ka shkelur së pari Kushtetutën e Kosovës, nenin 32, Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe vetë Ligjin për Prokurimin publik, përmes vendimit të kundërligjshëm dhe pa arsyetim dhe as udhëzim për mjetin juridik.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, provat e bashkëngjitura, dispozitat e shkelura ligjore, kërkesat e dosjes së tenderit konstatohet në mënyrë të pakontestueshme se OE Ankues ka të drejtë lidhur me pretendimet e ngritura, që të gjitha këto pretendime në një analizë të mirëfillte të provave dhe bazës ligjore dështojnë shkeljet e bëra nga AK dhe domosdoshmërinë e anulimit të vendimit të AK.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*
1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 9001 2015 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit.	**1. Certifikata ISO 9001 2015 (kopje).**
2. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 14001 2015 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit.	**2. Certifikata ISO 14001 2015 (kopje).**
3. Operatori Ekonomik ose grupi i	**3. Certifikata ISO 45001 2018 (kopje).**

operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 45001 2018 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit.	
4.Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë Një (1) Menaxher te Projektit i cili duhet të jetë i kualifikuar dhe i certifikuar për menaxhim te mjedisit, min. 3 vjet përvojë pune ne DDD.	**4.Për menaxherin e Projektit të paraqiten Diploma universitare, Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi – (origjinal), CV e nënshkruar, certifikata e akreditimit për menaxhim te mjedisit valide –kopje, Referencat për përvojën e punës**
5. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë Një (1) Epidemiolog, ose Agronom ose Veterinar ose Ekolog.	**5. Diploma Universitare-kopje , Licenca e punës –valide kopje, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt.**
6. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë Një (1) teknik sanitar.	**6. Diploma ose certifikat-kopje , Licenca e punës –valide kopje, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt.**
7. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë tetë (8) punëtor teknik.	**7. Kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt.**
8. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë Një (Gjeneratorë Ultra Low Volume ULV) qe vendosen ne kamionet -Tri - Pompa motorike -Tri -ULV elektrike - Tri ULV elektrostatike -Tri Pompa me presion -Një Pajisje adekuate për insekte me avull te nxehte dhe te thate me temperature minimumi 60 0C .	**8.OE duhet të ofrojë një listë me foto për të gjitha pajisjet e kërkuara për realizimin e këtij projekti, lista duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosura si dhe dëshmitë e posedimit të tyre. OE për të gjitha pajisjet duhet të ofroj dëshmitë Faturë, Dud doganor apo marrëveshje të marrjes me qira, ku edhe qiradhënësi duhet ti ofroj dëshmitë e posedimit (Faturë, DUD).**
9. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë Katalog ose broshurë me përshkrim teknik dhe foto për të gjithë produktet e kërkuara.	**9.Operatoret ekonomik, duhet të sjellin katalogët ose broshura për artikujt e kerkuar, Katalogët ose broshurat, duhet të jenë të shoqëruara me përshkrim të detajuar të specifikimeve teknike dhe te jen ne perputhje me kerkesat ne Aneksin 1 te dosjes se tenerit**
10. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë Certifikatat e Analizave dhe MSDS për te gjitha preparatet e kërkuara te specifikimet teknike.	**10.Certifikatat e Analizave dhe MSDS (kopje)**

11.Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë duhet të kenë përfunduar kontrata për sherbime të ngjashme , shuma e të cilave kanë qenë në vlerë jo me pak se 200,000.00 € , të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.	**11.Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Listës duhet ti bashkëngjiten dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i sherbimeve për kontratat dhe projektet e cekura në listë, (kopje).**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

DATË/A:	28.07.2023
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	OE, DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K, nga Prishtina
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	e-prokurimit
NGA/OD/FROM:	Agim ISLAMI, Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit -MPB
TE MA/ SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim në Kërkesën për Rishqyrtim, për Aktivitetin e prokurimit, "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare ", me nr. të prokurimit : 214 / 23 / 6093/ 211

Ministria e Punëve të Brendshme, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtimi të Operatorit Ekonomik, DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K, nga Prishtina, të datës 26.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me Titull: "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare ", me nr. të prokurimit : 214 / 23 / 6093/ 211, kundër Njoftimit për kontratë dhe dokumenteve të tenderit të datës 20.06.2023 publikuara në platformën elektronike, AK, mbështetur në Ligjit nr. *Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (LPP)*, neni 108/A, nxjerr këtë:

VENDIM

I. REFUZOHET Kërkesa për rishqyrtime e Operatorit Ekonomik DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K, nga Prishtina, **e pa bazuar,** lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare ", me nr. të prokurimit : 214 / 23 / 6093/ 211, kundër Njoftimit për kontratë dhe dokumenteve të tenderit të publikuar me datë 20.06.2023.

Autoriteti Kontraktues-MPB, për këtë aktivitet të prokurimit të cekur më lartë, ka zhvilluar procedurën me të dhënat si vijon:

- Njoftimi për Kontrate, ...20.06.2023;
- 1-Informacione, sqarime shtesë të DT.....07.07.2023;
- 2-Informacione sqarime shtesë të DT 14.07.2023;
- Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: ..... 31.07.2023 ora : 13:30
- Data dhe ora e hapjes se ofertave: ..... 31.07.2023 ora: 13:30
- Kriteri për dhënie te kontratës : Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët;
- Kërkesë për Rishqyrtim nga Operatori Ekonomik DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K, nga Prishtina..... 26.07.2023;

PRETENDIMET ANKIMORE

Operatorët Ekonomik DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K, nga Prishtina, si palë të pakënaqura kanë parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim tek AK me datën 26.07.2023, kundër Njoftimit për kontratë dhe dokumenteve të tenderit, për tenderin, "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare ", me nr. të prokurimit : 214 / 23 / 6093/ 211, duke pretenduar së janë bere shkelje të dispozitave të *Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (LPP)*, siç janë:
Neni 1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.
Neni 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.
Neni 9 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.
Neni 27 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.
Neni 28 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.
Neni 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik.

O Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1 par. 1, 2 dhe 3 të ligjit për Prokurim Publik. Ashtu që neni 3 par.1 i Ligjit për Prokurorimin publik përcakton se "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla", e që AK, në mënyrë direkte i shkelë të tre paragarafet e nenit 1 të LPP-së, me rastin e përgatitjes së një specifikacioni të tillë në dosjen e tenderit.

Autoriteti Kontraktues ka dështuar të veprojë sipas nenit 7 par.1 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", lidhur me par.5 të nenit 7 të LPP-së, ceket se "Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit. Autoriteti kontrakutes e shkel nenin 7 te LPP-së, në të gjashtë paragrafët me rastin e pergaditjes se nje specifikacioni të tillë në dosjen e tenderit për shkak se kërkon menaxher të kualifikuar, çertifikuar për menaxhim të mjedisit me përvojë pune min. 3 vite, në kryerjen e shërbimeve të DDD. Kurse në të njëjtën kohë cek se opertori ekonomik

2

apo grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojnë se kanë 1 Epidemolog ose Agronom ose Veterinar ose Ekolog, gjë e cila paraqet standard të dyfisht profesional, dhe janë kërkesa që bijen ndesh apo në kundërshtim me njëra tjetren sepse operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik i bije që përpos që psh. Të njëjtin person 1 Epidemolog ose Agronom ose Veterinar ose Ekolog, gjithsesi se duhet të jetë edhe nje menaxher, andaj kjo pikë e dosjes së tenderit sipas pyetjes se parë të bërë ne si OE, paraqet standard favorizues për ndonjë OE, të caktuar e për në në të njëjtën kohë edhe është kriter diskriminues.

O Autoriteti kontraktues ka bere shkelje nenit 7 par.1 të LPP-së, përseri në rastin kur kanë kërkuar diplomë universitare për menaxher dhe i çertifikuar për mbrojtjen e mjedisit me përvojë pune min. 3 vite në kryerjen e shërbimeve të DDD, që i përkasin vetëm mjedisit, bujqësi, biologji, kimi dhe ekologji. Kjo pikë si përgjigje e dhënë nga AK është në kundërshtim me përgjigjen e parë të dhënë për shkak se aty ka cekur se edhe epidemologu kërkohet, kurse në përgjigjen e dytë jo, që këto tani janë në kundërshtim me njëra tjetrën, po ashtu pse duhet të jetë menaxher i mjedisit dhe pse duhet të jetë i çertifikaur, kjo është diskriminuese dhe standard të dyfisht profesional. Kerkojme nga AK te hiqet komplet menaxheri i certifikuar per mbrojtjen e mjedisit.

O Autoriteti kontraktues ka bere shkelje të nenit 7 të LPP-së, përseri në rastin kur kanë kërkuar që CV, të jetë e nënshruar, kurse edhe në përgjigjen e dhënë vetëm kanë cekur se kërkesa mbetet e njëjtë si në dosjen e tenderit, por kjo kërkesë që CV, të nënshkruhet është një kërkesë absurde dhe shumë e panevojshme për arsye se CV, vetëm në mënyrë të shkurtër paraqet profilin e personit që i dedikohet dhe është fakt notor pra i ditur botërisht që CV-ja, asnjeherë nuk kërkohet e nënshkruar, prandaj kjo duhet hequr/përmirësuar si kërkesë në dosjen e tenderit.

Autoriteti kontraktues ka bere shkelje te ketij neni të lartë cekur përseri në rastin kur kanë kërkuar vetëm një gjenerator Ultra Low Volume –ULV, për mbi 224,7000.00 m2, duke cekur në përgjigjen e AK, se kinse vetëm një gjenerator i tillë është i mjaftueshëm për arsye se vetëm Pallati i Drejtësisë ka një sipërfaqe prej 13,960.00 metra katror kurse objektet tjera me siperfaqe të ulta deri në 20 m2, e që sipas tyre mund të kryhet me pompa tjera, mirëpo një konstatim i tillë i AK, nuk është i sakt sepse ky proces tenderimi është me të gjitha objektet qeveritare e që objekt qeveritar është edhe objekti i AKI-së, apo Ministrive tjera përkatëse, që si të tilla nuk i ka 20 m2, pra kemi sipërfaqe shumë më të madhe e që nuk mund të kryhet me pompa tjera dhe pa gjenerator, andaj kjo kërkesë vetëm për një gjenerator është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, për shkak se shihet qartë se me këtë po favorizohet ndonjë OE, që ka vetëm një gjenerator.Vlen te ceket se Autoriteti Kontraktues gjithashtu nuk kerkon asnje automjet per kryerjen e sherbimeve, ku per kete projekt madhor duhen se paku te jene 5 automjete për bartjen e gjeneratoreve, punetoreve, pompave motorike etj.

O Autoriteti kontraktues ka dështuar të veproj konform nenit 6 të LPP-së, në të cilin ceket se "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më konomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.", ndersa autoriteti kontraktues vepron kunder ketij neni e rrjedhimisht kunder ligjit te prokurimit publik në tërësi me rastin e vendosjes se kërkesës për 3 pompa ULV Elektrike dhe 3 pompa ULV Elektrostatike, pra duke i kërkuar gjithsjet 6 pompa që në mënyrë automatike dëmton buxhetin publik pra të shtetit, si dhe përgjigjja e AK, se kinse këto pompa nuk janë të njëjta pra kinse pompat ULV elektrike janë pompa që mund të përdoren për dezinsektim dhe dezinfektim, kurse pompa ULV Elektrostatike vetëm për dezinfektim, por që ky një konstatim i gabuar dhe jo i saktë nga ana e AK, për shkak se pompa ULV Elektrostatike përdoren edhe për dezinfektim edhe për dezinsektim mandje janë edhe shumë profesinale. O Autoriteti Kontraktues ka shkelur edhe nenin 9 par.1 të LPP-së, përcaktohet se "Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit,

ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'I plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës
publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë; (iv) përfitimet e pritura nga secili objekt i tillë; (v) në rastin e pajisjeve, mallrave të qëndrueshme dhe punëve, përllogaritja e shpenzimeve të disponimit gjatë tërë afatit të

përdorimit të objektit, duke përfshirë shpenzimet e blerjes, operative, mirëmbajtjes si dhe vlerës së mbetur; (vi) një njoftim, mbi atë se nëse aktiviteti i tillë i prokurimit ishte përfshirë në planifikimin e prokurimit, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe nëse nuk ishte përfshirë, atëherë një deklaratë mbi arsyet e mos-përfshirjes së tillë; dhe (vii) konstatimin e saktë mbi atë se në çfarë mënyre do të avancojë prokurimi përkatës synimet institucionale të autoritetit kontraktues" andaj vlerësojmë se AK ka bërë shkelje të këtij nenit me rastin e kërkesën për një paisje adekuate për insekte me avull të nxeht dhe të thatë (sqarim: Avull i nxehet dhe i thatë nuk ekziston), për lirimin e avullit të nxeht nga temp. 60 C deri në 200 C, dhe nga AK është kërkuar minimun deri në 60 C, që kinse kjo temperatur e mjaftueshme për eliminimin e insekteve, vezëve dhe lavrave të tyre, dhe kinse kjo kërkesë është që të mos eleminohet konkurrenca, por që AK, këtu bënë shkelje pikërisht të konkurrencës duke favorizuar ndonjë EO që ka këtë paisje, po ashtu vlen të ceket se temperatura adekuate për ti eliminuar lavrat dhe vezët është 100 C, deri në 180 C, dhe në asnjë mënyrë 60 C.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, në rastin e kërkesës për repelent për largimin e brejtësve me përmbajtje organike dhe jo të rrezikshme për njerëz dhe mjedisin, por ky një konstatim i gabuar nga ana e AK, për arsye se së pari për brejtës nuk duhet të përdoren Repelent por duhet të kryhet shërbimi i Deratizimit që shërben për eleminimin dhe kontrollimin e brejtësve, e jo repelent, sepse me repelent psh. Në hapësira të mëdha siç është pallati i drejtësisë i bije e brejtësit vetëm i largon nga një hapësirë/objekt e i dërgon në një tjetër, pra nuk duhet repelent por duhet të kryhet
shërbimi i Deratizimit siç u sqarua më lartë.

O Autoriteti Kontraktues në pikën që ka të bëjë me atë se OE duhet ti mbledhin brejtësit e ngordhur dhe deponimi i tyre është përgjegjësi e tyre, po ashtu në dosjen e tenderit kanë cekur se brejtësit e ngordhur duhet të dergohet në deponi të autorizuara për të njëjtat, e sipas AK, në Kosovës kinse paska deponi të autorizuara për këtë gjëra që nuk është e vërtet, dhe në mënyrë automatike e lën përgjegjesinë tek OE. O Autoriteti Kontraktues në specifikacionin teknik ka kërkuar për Parandalimin – Largimin e dëmtueseve tjerë (zvarranikëve dhe shpendëve), ka cekur se duhet përdor Cinamon oil, Canfora oil ose ekuvalente, por i ka futur në një kategori, që është gabim ,por që ky është një gabim sepse AK, në mënyrë të gabuar i ka dhënë produkte të njëjta sikurse për largimin e zvarranikëve ashtu edhe të shpendëve, por për largimin e shpendëve ka produkte tjera shumë më efikase si gjemba, shirita elektrik. Po ashtu AK ka injoruar pyetjet e bëra nga OE, pra nuk është përgjigjur.

O Autoriteti Kontraktues në specifikacionin teknik ka kërkuar të përdoren pllaka aromatike me ngjitës të mijëve jo toksike për njerëz, kurse pyetja jonë si OE, ka qenë si dëshmohet se ngjitësat janë jo toksik, kurse AK, ka theksuar se për të dëshmuar cilësinë e perparateve të kërkuara duhet të ofrohen kopjet e çertifikatave të analizave dhe MSDS, por gabimisht është kjo përgjigje sepse fillimisht këtu janë kërkuar ngjitësa dhe jo preparate, këto ngjitësa si të tilla nuk kanë çertifikata të analizave dhe as MSDS, por vetëm përcillën me letër nga prodhuesi që nuk janë toksike, andaj AK në këtë mënyrë redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. O Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 9 të LPP-së, me rastin e mosharmonizimit te kerkesave në terren dhe numërit të punëtorëve që duhet dhe janë të nevojshëm për përfundimin e këtij projekti sepse edhe sipas vetë AK, kry projekt është madhor, e në anën tjetër në dojsen e tenderit pretendon që në afatin prej 30 ditësh ta përfundoj me 8 puntorë është shumë e pa qartë dhe vështirë e realizueshme, sepse ne si OE, kemi planifikuar për këtë tender ta realizojmë eventualisht me 18 puntor për shkak të afatit të shkurtër të ekzekutimit të punëve.

Bazuar ne krejt çka kemi thene me larte, kerkojmë nga autoriteti kontraktues Qeveria e Reublikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme, qe pas shqyrtimit te kerkeses sone per rishqyrtim dhe marrjes per baze te fakteve te permendura nga ne, te merr vendim per aprovimin e ankeses tone dhe te beje anulimin e ketij aktivitet te prokurimit.

Ministria e Punëve të Brendshme–ZPP, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore- Operatorit Ekonomik ankues DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K, nga Prishtina.

Në zbatim të, *LPP-së* Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, nxjerrë këtë përfundim: KËRKESA PËR RISHQYRTIM, Refuzohet e PABAZUAR.

DEKLARATË DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET

Pretendimi i Operatorit Ekonomik ankues DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K, nga Prishtina, së Autoriteti Kontraktues me publikimin e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit në platformën elektronike e-prokurimi me datën 20.06,2023, ka shkelur nenet: Neni 1; nenin 7; nenin 9; nenin 27; nenin 28; dhe nenin 109 të LPP-së për aktivitetin e prokurimit "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare ", me nr. të prokurimit : 214 / 23 / 6093/ 211, **është i pabazuar**.

Publikimi i Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përkundër pretendimeve tuaja është në përputhje të plotë me LPP-së dhe aktet dytësore të këtij Ligji.

Përgjigje në pretendimet Ankimore

Ministria e Punëve të Brendshme –ZPP, pas pranimit të Kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore, të Operatori Ekonomik DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K, nga Prishtina. Pas analizës së pretendimeve të cekura në Kërkesën për rishqyrtim, kundër Njoftimit për Kontratë dhe dokumenteve të tenderit të datës 20.06.2023, sqarimeve shtesë të publikuara në platformën elektronike, në konsultim me njësinë kërkuese AK ka ardhur në konkludim së nuk kemi të bëjë me shkelje të Neneve të lartë cekuar të LPP-së.

Detale dhe argumente për pretendimet e neneve të shkelura dhe pikat ankimore për rishqyrtim të lartcekura nga OE, Autoritetin Kontraktues –Ministria e Punëve të Brendshme, konstaton së ka vepruar në harmoni të plot me LPP-në dhe nenet: **Neni 1 Qëllimi; Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti; Nenin 7 Barazia në Trajtim / Jo diskriminim, Neni Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur; Neni 27 Dosja e Tenderit; Nenin 28 Specifikimet teknike dhe Nenin 109 Afatet për Dorëzimin e Ankesës** AK-MPB ka trajtuar në mënyre të barabarta dhe pa diskriminim të gjithë OE-të në këtë AP dhe është në harmoni të plotë me LPP-në dhe aktet tjera dytësore mbi prokurimin publik të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

1. **Pretendimet tuaja ankimore mbi kërkesat teknike dhe profesionale**, së janë shkelur nenet e lartë cekura, Autoriteti Kontraktues vlerëson se nuk qëndron dhe është i pabazuar, sepse me këto kërkesa të vendosura nuk kemi të bëjmë me kurrfarë diskriminimi dhe trajtim të pabarabartë për Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, janë vendosur dhe kërkuar nga AK, në pajtim me LPP-në, neni 69, këto kërkesa të kualifikimit profesionale dhe edukative të stafit menaxherial dhe stafit profesional. janë kërkesa minimale për këtë projekt me rëndësi të veçantë për AK, të cilat kërkesa përcaktojnë dhe sigurojnë Autoritetin Kontraktues për nivelin e mirëmbajtjes, menaxhimit kualitativ dhe profesional te projektit nga ana e kompanisë ofertuese, proces te menaxhimit dhe realizimit kualitativ te këtyre shërbimeve komplekse.
Këto kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, janë minimale dhe në harmoni me LPP-në.

AK, për Stafin profesional për realizim të këtij projekti, nuk ka kërkuar ti kenë në marrëdhënie pune por ka mundësuar që Operatori Ekonomik pjesëmarrës të ofrojnë Kontratë ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), andaj në këtë rast nuk kemi të bëjë me shkelje të asnjë Neni të LPP-së.

AK – është në harmoni të plotë me Neni 69 të LPP-së: paragrafi;

4. Në procedurat që shpien në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkohen lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomik mund të parashtrohen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen:

4.1. kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve;

4.4. raportin mbi fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e fundit;

4.5. raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve;.

Duke u mbështetur në shtjellimet e lartë cekura, kompleksitetit të këtij aktivitet të prokurimit i cili ka të bëj me shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim në ndërtesat qeveritare dhe përdorimi e preparateve me materie të rrezikshme ku ky shërbim duhet të kryhet në ambiente të cilat janë të mbushura me staf (njerëz) dhe në të njëjtën kohë kemi të bëjmë me ruajtje e shëndetit të përgjithshëm publik AK edhe një here konstaton që kërkesat e vendosura janë minimal jo diskriminuese dhe të domosdoshme për realizim të këtij projekti.

2. Pretendimet tuaja ankimore për specifikat teknike, së janë shkelur nenet e lartë cekura, Autoriteti Kontraktues vlerëson se nuk qëndron dhe është i pabazuar ky pretendim, sepse të gjithat specifikimet teknike janë në harmoni me nevojat e AK jo diskriminuese dhe favorizuese për asnjë OE, dhe janë të hartuara nga struktura të specializuara të njësisë së kërkesës të cilat janë për përputhje të plotë me LPP-në dhe nevojat e AK-së, mbetet përgjegjësi e OE-së që shpallet fitues deponimi i materialeve (si brejtësve zvarranikëve etj.) sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovë për asgjësim dhe kompetencave ligjore mbi të cilat operon veprimtaria e biznesit.

Edhe një here ju sqaroj së është në kompetencë të plotë ligjorë të AK-së vendosja e kritereve specifike dhe hartimi i specifikave teknike në harmoni me natyrën e AP-së.

Ministria e Punëve të Brendshme–ZPP, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore të gjitha janë të cekura më lartë.
Në zbatim të, *Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092* Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, nxjerrë këtë përfundim:

Konkluzion:

I. REFUZOHET Kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K, nga Prishtina, **e pa bazuar**, kundër Njoftimit për kontratë dhe dokumenteve të tenderit nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për tenderin "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare **", me nr. të prokurimit : 214 / 23 / 6093/ 211.**

II. Mbetet në fuqi Njoftimin për Kontratë i publikuar me 20.06.2023 me sqarimet shtesë të publikuara në platformën elektronike nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me aktivitetin e prokurimit për "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare **", me nr. të prokurimit : 214 / 23 / 6093/ 211**.

III. Ministria e Punëve të Brendshme, në harmoni me Nenin 63.1.1 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik pika b) vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit me Titull: "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare **", me nr. të prokurimit : 214 / 23 / 6093/ 211.**

IV. Ministria e Punëve të Brendshme nga provat e prezantuara me lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Operatorit Ekonomik: DOCTOR EXTERMINATOR D.D.D. SH.P.K, nga Prishtina
2. Platformë elektronike: https://e-prokurimi.rks-gov.net/ e MPB-ës.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**

Sqarim hyrës:

Me datën: 31.07.2023, OE "DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0529, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sherbime per Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim per Ndertesat Qeveritare" me nr. të prokurimit: "214-23-6093-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 316,560.00 €.

Pretendimi 1

Sipas OE ankues: "Autoriteti Kontraktues ka dështuar të veprojë sipas nenit 7 par.1 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", lidhur me par.5 të nenit 7 të LPP-së, ceket se "Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit. Autoriteti kontraktues e shkel nenin 7 te LPP-së, në të gjashtë paragrafët me rastin e përgatitjes se një specifikacioni të tillë në dosjen e tenderit për shkak se kërkon menaxher të kualifikuar, certifikuar për menaxhim të mjedisit me përvojë pune min. 3 vite, në kryerjen e shërbimeve të DDD. Kurse në të njëjtën kohë cek se operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojnë se kanë 1 Epidemiolog ose Agronom ose Veterinar ose Ekolog, gjë e cila paraqet standard të dyfishte profesional, dhe janë kërkesa që bijën ndesh apo në kundërshtim me njëra tjetër sepse operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik i bije që përpos që p.sh. Të njëjtin person 1 Epidemiolog ose Agronom ose Veterinar ose Ekolog, gjithsesi se duhet të jetë edhe menaxher, andaj kjo pikë e dosjes së tenderit sipas pyetjes se parë të bërë na ne si OE, paraqet standard favorizues për ndonjë OE, të caktuar e për ne në të njëjtën kohë edhe është kriter diskriminues."

Eksperti shqyrtues sqaron se në Dosjen e Tenderit, AK- Ministria e Punëve të Brendshme tek pjesa e kërkesave të përshtatshmërisë dhe ato profesionale ka përfshirë edhe kërkesën si më poshtë:

c. Autorizim ose licencim ose anëtarësim ne një organizate te veçantë për shërbime profesionale te lëshuar nga një autoritet përkatës.	**c.Kopja e Lejes e lëshuar nga institucionet Relevante për përdorimin e preparateve dhe kryerjen e shërbimeve për DDD brenda territorit te Republikës se Kosovës.**

AK ka kërkuar që OE të dorëzojnë në ofertat e tyre edhe lejën e lëshuar nga institucionet relevante për përdorim dhe kryerje të shërbimeve për DDD, leje e cila lëshohet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe njihet si leje e përkohshme për dezinfektim, dezinsektim dhe deratizim. Leja e cila lëshohet nga ky institucion relevant, lëshohet për të gjithë ata të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e caktuara të kërkuara për ofrim të këtyre shërbimeve përkatëse. Duke marrë parasysh se për t'u pajisur me këtë leje një OE duhet të ketë stafin e profileve të caktuara për ofrim të këtyre shërbimeve, vlerësojmë se një kërkesë e tillë se OE duhet të kenë një Epidemiolog ose një Agronom ose një Veterinar ose një Ekolog që po ashtu duhet të jetë edhe menaxher me përvojë pune të paktën 3 vite në

menaxhim të mjedisit është një kërkesë që kufizon konkurrencën pasi që edhe Operartorët Ekonomik që janë të licencuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie po i mohohet e drejta për të marr pjesë në këtë aktivitet prokurimi. Eksperti shqyrtues vlerëson se sa i përket titujve dhe kualifikimeve të cilat duhet t'i kenë OE që pajisjen me Leje për DDD, është tërësisht në kompetencë të MBPZHR dhe jo të AK për të përcaktuar se çfarë profile duhet të ketë OE për ofrim të këtyre shërbimeve.

Andaj konsiderojmë që ky pretendim i ngritur nga OE ankues është i bazuar.

Pretendimi 2

"Autoriteti kontraktues ka bere shkelje nenit 7 par.1 të LPP-së, përsëri në rastin kur kanë kërkuar diplomë universitare për menaxher dhe i çertifikuar për mbrojtjen e mjedisit me përvojë pune min. 3 vite në kryerjen e shërbimeve të DDD, që i përkasin vetëm mjedisit, bujqësi, biologji, kimi dhe ekologji. Kjo pikë si përgjigje e dhënë nga AK është në kundërshtim me përgjigjen e parë të dhënë për shkak se aty ka cekur se edhe epidemiologu kërkohet, kurse në përgjigjen e dytë jo, që këto tani janë në kundërshtim me njëra tjetrën, po ashtu pse duhet të jetë menaxher i mjedisit dhe pse duhet të jetë i çertifikaur, kjo është diskriminuese dhe standard të dyfishte profesional."

Siç e kemi cekur edhe në pretendimin më lartë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit sa i përket profileve dhe përvojës së stafit kur është kërkuar që OE të dëshmojnë se kanë marrë lejen e përkohshme për Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim nga institucioni relevant-MBPZHR, vlerësojmë se kjo leje i mbulon të gjitha këto kërkesa, pra është tërësisht kompetencë e institucionit përkatës për të vendosur nëse një OE lejohet të realizoj këtë aktivitet apo jo. Pra institucioni përkatës për lëshimin e kësaj leje për DDD kërkon nga OE të përmbushin disa kërkesa duke përfshirë profilet e nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi. Andaj edhe ky pretendim i ngritur nga OE ankues është i bazuar.

Pretendimi 3

OE ankues pretendon se "Autoriteti kontraktues ka bere shkelje të nenit 7 të LPP-së, përsëri në rastin kur kanë kërkuar që CV, të jetë e nënshkruar, kurse edhe në përgjigjen e dhënë vetëm kanë cekur se kërkesa mbetet e njëjtë si në dosjen e tenderit, por kjo kërkesë që CV, të nënshkruhet është një kërkesë absurde dhe shumë e panevojshme për arsye se CV, vetëm në mënyrë të shkurtër paraqet profilin e personit që i dedikohet dhe është fakt notor pra i ditur botërisht që CV-ja, asnjëherë nuk kërkohet e nënshkruar, prandaj kjo duhet hequr/përmirësuar si kërkesë në dosjen e tenderit."

Në pretendimin e tretë të ngritur nga OE ankues sa i përket kërkesës së Dosjes së Tenderit ku është kërkuar që CV-të e dërguara po ashtu të jenë të nënshkruara, eksperti shqyrtues sqaron se një kërkesë e tillë është e drejtë të bëhet nga AK përderisa nuk është një kërkesë e cila paraqet ngarkesë shtesë për OE që marrin pjesë në këtë aktivitet prokurimi. Andaj vlerësojmë se ky pretendim është i pabazuar.

Pretendimi 4

"*Autoriteti kontraktues ka bere shkelje te këtij neni të lartë cekur përsëri në rastin kur kanë kërkuar vetëm një gjenerator Ultra Low Volume –ULV, për mbi 224,7000.00 m2 , duke cekur në përgjigjen e AK, se kinse vetëm një gjenerator i tillë është i mjaftueshëm për arsye se vetëm Pallati i Drejtësisë ka një sipërfaqe prej 13,960.00 metra katror kurse objektet tjera me sipërfaqe të ulta deri në 20 m2 , e që sipas tyre mund të kryhet me pompa tjera, mirëpo një konstatim i tillë i AK, nuk është i saktë sepse ky proces tenderimi është me të gjitha objektet qeveritare e që objekt qeveritar është edhe objekti i AKI-së, apo Ministrive tjera përkatëse, që si të tilla nuk i ka 20 m2 , pra kemi sipërfaqe shumë më të madhe e që nuk mund të kryhet me pompa tjera dhe pa gjenerator, andaj kjo kërkesë vetëm për një gjenerator është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, për shkak se shihet qartë se me këtë po favorizohet ndonjë OE, që ka vetëm një gjenerator. Vlen te ceket se AUTORITETI KONTRAKTUES nuk kerkon asnje automjet per kryerjen e sherbimeve, ku per kete projekt madhor duhen te jene se paku 5 automjete per bartjen e gjeneratoreve, punetore, pompa motorike etj."*

Mendimi i eksperti teknik është se pretendimi i ngritur nga OE e konstaton si të pabazuar sepse për të bërë DDD në të gjitha hapësirat, përveç gjeneratorit, mund të përdoren edhe pompa të ndryshme ashtu siç janë të cekura edhe në dosje të tenderit (p.sh pompa motorike, pompa me presion etj).

Pretendimi 5

"Autoriteti kontraktues ka dështuar të veproj konform nenit 6 të LPP-së, në të cilin ceket se "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.", ndërsa autoriteti kontraktues vepron kunder këtij neni e rrjedhimisht kundër ligjit te prokurimit publik në tërësi me rastin e vendosjes se kërkesës për 3 pompa ULV Elektrike dhe 3 pompa ULV Elektrostatike, pra duke i kërkuar gjithsejte 6 pompa që në mënyrë automatike dëmton buxhetin publik pra të shtetit, si dhe përgjigjja e AK, se kinse këto pompa nuk janë të njëjta pra kinse pompat ULV elektrike janë pompa që mund të përdoren për dezinsektim dhe dezinfektim, kurse pompa ULV Elektrostatike vetëm për dezinfektim, por që ky një konstatim i gabuar dhe jo i saktë nga ana e AK, për shkak se pompa ULV Elektrostatike përdoren edhe për dezinfektim edhe për dezinsektim madje janë edhe shumë profesionale."

Eksperti teknik konstaton këtë pretendim si të pabazuar sepse në momentin që në dosje të tenderit kërkohet vetëm nje gjenerator ULV, dezinfektimi duhet të bëhet me metoda tjera në këtë rast me përdorimin e pompave siç janë elektrike dhe elektrostatike.

Ndërsa pohimin e OE ku thekson se ULV elektrostatike nuk përdoren vetëm për dezinfektim, por përdoren edhe për dezinsektim e konstaton të bazuar, sepse shumica e kimikateve që mund të përdoren tek ULV elektrike, mund të përdoren në ULV elektrostatike. Dezinfektuesit, pesticidet, fungicidet dhe kimikatet e tjera anti-mikrobike mund të përdoren në mënyrë më efektive për të mbuluar sipërfaqet, si brenda ashtu edhe jashtë. Përmendet se pompat elektrostatike janë shume profesionale sepse reduktojnë kohën që duhet për tu përhapur dhe

mbuluar, si dhe dezinfekton të gjitha sipërfaqet, qoshet dhe çarjet.

Efikasiteti: Kimikatet aplikohen në një mënyrë shumë më të kontrolluar, efikase dhe të rregullt. Përmirëson kontrollin e infeksionit dhe përhapja e viruseve dhe bakterieve bëhet më mirë.

Pretendimi 6

"Autoriteti Kontraktues ka shkelur edhe nenin 9 par.1 të LPP-së, përcaktohet se "Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë; (iv) përfitimet e pritura nga secili objekt i tillë; (v) në rastin e pajisjeve, mallrave të qëndrueshme dhe punëve, përllogaritja e shpenzimeve të disponimit gjatë tërë afatit të përdorimit të objektit, duke përfshirë shpenzimet e blerjes, operative, mirëmbajtjes si dhe vlerës së mbetur; (vi) një njoftim, mbi atë se nëse aktiviteti i tillë i prokurimit ishte përfshirë në planifikimin e prokurimit, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe nëse nuk ishte përfshirë, atëherë një deklaratë mbi arsyet e mos-përfshirjes së tillë; dhe (vii) konstatimin e saktë mbi atë se në çfarë mënyre do të avancojë prokurimi përkatës synimet institucionale të autoritetit kontraktues" andaj vlerësojmë se AK ka bërë shkelje të këtij nenit me rastin e kërkesën për një pajisje adekuate për insekte me avull të nxeht dhe të thatë (sqarim: Avull i nxehet dhe i thatë nuk ekziston), për lirimin e avullit të nxeht nga temp. 60 C deri në 200 C, dhe nga AK është kërkuar minimun deri në 60 C, që kinse kjo temperaturë e mjaftueshme për eliminimin e insekteve, vezëve dhe lavrave të tyre, dhe kinse kjo kërkesë është që të mos eliminohet konkurrenca, por që AK, këtu bënë shkelje pikërisht të konkurrencës duke favorizuar ndonjë OE që ka këtë pajisje, po ashtu vlen të ceket se temperatura adekuate për ti eliminuar lavrat dhe vezët është 100 C, deri në 180 C, dhe në asnjë mënyrë 60 C."

Ekspertit teknik konstaton se pretendimi i ngritur nga OE është i bazuar sepse temperatura adekuate për eleminimin e vezëve dhe insekteve është 100 -180 C.

Avantazhi i dukshëm i trajtimit me avull është natyra e tij pa përdorimin e kimikateve, duke tërhequr individët të shqetësuar për rreziqet e mundshme shëndetësore që lidhen me insekticidet. Duke u mbështetur vetëm në fuqinë e nxehtësisë, avulli zhduk insektet pa lënë pas asnjë mbetje kimike, kjo jo vetëm që ofron një alternativë të sigurt dhe miqësore me mjedisin, por gjithashtu zvogëlon rrezikun e ekspozimit ndaj substancave të dëmshmë për shëndetin e njeriut sepse në dosje të tenderit është e cekur se do të përdoret në vendet siç janë: në objektet e qendrave për strehim dhe riatdhesim ku do të bëhet dezinfektimi i shtretërve dhe mobiljeve.

Pretendimi 7

"Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, në rastin e kërkesës për repelent për largimin e brejtësve me përmbajtje organike dhe jo të rrezikshme për njerëz dhe mjedisin, por ky një konstatim i gabuar nga ana e AK, për arsye se së pari për brejtës nuk duhet të përdoren Repelent por duhet të kryhet shërbimi i Deratizimit që shërben për eleminimin dhe kontrollimin e brejtësve, e jo repelent, sepse me repelent psh. Në hapësira të mëdha siç është pallati i drejtësisë i bije qe, brejtësit vetëm i largon nga një hapësirë/objekt e i dërgon në një tjetër, pra nuk duhet repelent por duhet të kryhet shërbimi i Deratizimit siç u sqarua më lartë."

Pretendimi i ngritur nga OE ankues nuk është i bazuar sepse në dosjen e tenderit është e cekur qartë se ku duhet të përdoren repelentët dhe ku pllakat aromatike. AK në hapësirat e brendshme ka kërkuar që të përdoren pllaka me aromë ngjitëse të minjëve, ndërsa në hapësirat e jashtme ka kërkuar të përdoren produktet e repelentëve.

Pretendimi 8

Sipas OE ankues: "Autoriteti Kontraktues në pikën që ka të bëjë me atë se OE duhet ti mbledhin brejtësit e ngordhur dhe deponimi i tyre është përgjegjësi e tyre, po ashtu në dosjen e tenderit kanë cekur se brejtësit e ngordhur duhet të dërgohet në deponi të autorizuara për të njëjtat, e sipas AK, në Kosovës kinse paska deponi të autorizuara për këto gjëra që nuk është e vërtet, dhe në mënyrë automatike e lenë përgjegjësinë tek OE."

Pretendimi i ngritur nga OE ankues është i bazuar sqaron eksperti teknik, sepse në Kosovë nuk ekziston ndonjë deponi e autorizuar për brejtësit.

Pretendimi 9

"Autoriteti Kontraktues në specifikacionin teknik ka kërkuar për Parandalimin – Largimin e dëmtueseve tjerë (zvarranikëve dhe shpendëve), ka cekur se duhet përdor Cinamon oil, Canfora oil ose ekuvalente, por i ka futur në një kategori, që është gabim ,por që ky është një gabim sepse AK, në mënyrë të gabuar i ka dhënë produkte të njëjta sikurse për largimin e zvarranikëve ashtu edhe të shpendëve, por për largimin e shpendëve ka produkte tjera shumë më efikase si gjemba, shirita elektrik. Po ashtu AK ka injoruar pyetjet e bëra nga OE, pra nuk është përgjigjur."

Sipas ekspertit teknik ky pretendim është i pabazuar sepse në dosje të tenderit kërkohen aparate ekologjike siç janë: Vaji i kanellës dhe kamfurit.

-Kamfuri dhe vaji i kanellës janë repelentë efektivë ndaj gjarpërinjve.

-Po ashtu vaji i kanellës nuk u pëlqen zogjëve sepse i mban të irrituar, dhe të parehatshëm.

Pretendimi 10

" Autoriteti Kontraktues në specifikacionin teknik ka kërkuar të përdoren pllaka aromatike me ngjitës të mijëve jo toksike për njerëz, kurse pyetja jonë si OE, ka qenë si dëshmohet se ngjitësat janë jo toksik,

kurse AK, ka theksuar se për të dëshmuar cilësinë e perparateve të kërkuara duhet të ofrohen kopjet e çertifikatave të analizave dhe MSDS, por gabimisht është kjo përgjigje sepse fillimisht këtu janë kërkuar ngjitësa dhe jo preparate, këto ngjitësa si të tilla nuk kanë çertifikata të analizave dhe as MSDS, por vetëm përcillen me letër nga prodhuesi që nuk janë toksike, andaj AK në këtë mënyrë redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik."

Pretendimi i ngritur nga OE ankues është i bazuar sepse ngjitësat vetëm përcillen nga prodhuesi që nuk janë toksike. Nuk ekzistojnë kopjet e certifikatave dhe MSDS për këtë produkt.

Pretendimi 11

"*Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 9 të LPP-së, me rastin e mos-harmonizimit te kërkesave në terren dhe numrit të punëtorëve që duhet dhe janë të nevojshëm për përfundimin e këtij projekti sepse edhe sipas vetë AK, ky projekt është madhor, e në anën tjetër në dosjen e tenderit pretendon që në afatin prej 30 ditësh ta përfundoj me 8 punëtorë është shumë e pa qartë dhe vështirë e realizueshme, sepse ne si OE, kemi planifikuar për këtë tender ta realizojmë eventualisht me 15 punëtor për shkak të afatit të shkurtër të ekzekutimit të punëve."*

Sipas ekspertit teknik ky pretendim i ngritur nga OE është i pabazuar sepse në dosje të tenderit është i cekur numri minimal i punëtorëve, është përgjegjësi e OE se si do ti menaxhoj të gjitha aktivitetet për realizimin e këtij procesi.

Pretendimi 12

"Janë ripërsëritur edhe në ankesë pretendimet sikurse në kërkesën për rishqyrtim për arsye se AK, me qëllim apo pa qëllim ka dështuar të arsyetoj në mënyrë detale të gjitha pretendimet tona të ngritura, pra kemi vetëm parafrazime të dispozitave ligjore pa asnjë elaborim, pastaj vetëm sa kanë marrë copy paste të gjitha pretendime kurse asnjë nuk e kanë trajtuar në mënyrë të saktë dhe të plotë, vlen të ceket se në faqen 6 të vendimit në paragrafin e parë AK ka cekur se "AK për Stafin Profesional për realizimin të këtij projekti nuk ka kërkuar ti kenë në marrëdhënie punë por ka mundësuar që Operatori Ekonomik pjesëmarrës të ofrojnë Kontratë ose marrëveshjen e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt.....", ky arsyetim jepet tek pretendimet e ngritura lidhur me kërkesën që operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojnë se kanë 1 Epidemiolog ose Agronom ose Veterinar ose Ekolog, kurse pretendimi jonë nuk ka pasur të bëjë farë me atë se a duhet të ketë kontratë pune apo marrëveshje pune, që sqarimi i AK, lidhur me këtë është në tërësi i gabuar sepse pavarësisht a ke kontratë punë në çfarë do afati ajo është marrëdhënie pune, por pretendimi jonë ka qenë se të njëjtin person 1 Epidemiolog ose Agronom ose Veterinar ose Ekolog, gjithsesi se duhet të jetë edhe menaxher, andaj kjo pikë e dosjes së tenderit sipas pyetjes se parë të bërë nga ne si OE, paraqet standard favorizues për ndonjë OE, e ky një dallim esencial, pra pretendimet tona janë paraqitur pa përgjigje në vendimin e AK, si dhe përgjigjet janë shtrembëruar. Vetëm mund të behët një krahasim i thjesht nga OSHP lidhur me pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe lehtë konstatohet se vendimi i AK, ka dështuar të arsyetoj pretendimet e ngritura dhe me këtë rast ka bërë shkelje të dispozitave të lartë cekura të LPP-së."*

Ne vlerësojmë se përgjigja e AK në pretendimin e ngritur nga OE ankues në Kërkesën për Rishqyrtim nuk është në përputhje me pretendimin e ngritur. Pra në asnjë moment OE ankues nuk ka kritikuar AK për kërkesën e bërë sa i përket kontratave apo marrëveshjeve të punës që kanë OE me stafin që do të angazhohet, por pretendimi ka qenë se pse njëri nga profilet e kërkuara për DDD duhet të jetë edhe

menaxher i mjedisit. Andaj konsiderojmë se ky pretendim i ngritur nga OE ankues është i bazuar.

Pretendimi 13

"Vendimi i dt. 28.07.202 nga AK Ministria e Punëve të Brendshme – Divizioni i Prokurimit, për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, nuk është i mbështetur në asnjë dispozitë ligjore, në këtë vendim nuk ka pjesën arsyetuese të tij të shënuar se përse është marrë një vendim i tillë, i njëjti në fillim ka të cekur se është vendim, kurse në fund ka një konkluzion në formë të dispozitivit, po ashtu nuk e ka këshillën juridike për ushtrimin e mjeteve juridike që përpos që janë shkelje ligjore por edhe shkelje Kushtetuese.

Po ashtu vendimi i dt. 28.07.2023, i mungon edhe pjesa e Këshillës Juridike si element kryesor, për udhëzimin e palës për ushtrimin e mjeteve juridike, që është kategori kushtetuese e sanksionuar me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se "Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj". Këtë të drejtë e rregullon edhe neni 13 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton se "Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik", po ashtu edhe neni 109 par. 1 të LPP-së, përcaktohet se "Ankesa mund të dorëzohet nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktiviteteve ose procedurave të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje të këtij ligji". Kështu që AK, ka shkelur së pari Kushtetutën e Kosovës, nenin 32, Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe vetë Ligjin për Prokurimin publik, përmes vendimit të kundërligjshëm dhe pa arsyetim dhe as udhëzim për mjetin juridik."

Eksperti shqyrtues sa i përket këtij pretendimi të ngritur nga OE ankues se vendimi i lëshuar nga AK i cili e refuzon si të pabazuar kërkesën për shqyrtim nuk i përmbanë të gjitha elementet e një vendimi ashtu siç është e paraparë me ligjet në fuqi, vlerëson se mangësia e vendimit të lëshuar nga AK qëndron në mungesën e Këshillës Juridike e cila do të duhej të përfshihej në fund të çdo vendimi. Andaj pretendimi i ngritur nga OE ankues është pjesërisht i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**

Agnese Ibrahimi

Bademe Mullalija